


DEPARTAMENTI



I KONTABILITETIT
DHE
I PAGESAVE

BANKA E SHQIPËRISË

Departamenti i Kontabilitetit dhe Pagesave ushtron dy funksione kryesore:

- Organizimin e Sistemit Kontabël në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet të cilit regjistrohen të gjitha veprimet bankare që kryhen në Bankën e Shqipërisë, të cilat sjellin ndryshime në gjendjen financiare të saj. Për pasqyrimin e saktë dhe në kohë të gjendjes financiare të Bankës së Shqipërisë, mban librat e llogarive, duke zbatuar parimin e kontabilitetit 'me të drejta të konstatuara'. Në këtë kuadër, përgatiten dhe raportohen Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë në përputhje me IAS (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit). Gjithashtu, hartimi dhe ndjekja e buxhetit të Bankës së Shqipërisë, është një tjetër detyrë e rëndësishme që kryhet në bashkëpunim edhe me departamente e njësi të tjera të Bankës.
- Organizimin e shërbimit të Kleringut dhe të Shlyerjes së Pagesave me vlerë të vogël si dhe ai i Shlyerjes së Pagesave Nderbankare me vlerë të madhe në Lekë. Po kështu, mbikëqyret sistemi i pagesave në vend dhe merren masa për nxitjen dhe për funksionimin normal të tij në bashkëpunim me komunitetin bankar.

Gjatë viteve 1993-1996 nëpërmjet punës së këtij Departamenti është krijuar lista e llogarive të Bankës së Shqipërisë sipas praktikave të bankave qendrore dhe kushteve konkrete; është siguruar informatizimi i parë i regjistrimeve kontabël si dhe është nxitur përdorimi i instrumenteve *jocash* të pagesave, si çeku e urdhërpagesa, në kushtet e krijimit të sistemit bankar me dy nivele.

Gjatë viteve 1997 –2000 u siguroa kalimi nga sistemi kontabel mbi baza *cash*-i në sistemin e kontabilitetit "me të drejta të konstatuara"; u hartua manuali kontabel në zbatim të këtij parimi; u hartuan politikat kontabile mbi vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve të bilancit të Bankës së Shqipërisë; u përgatitën pasqyrat financiare të Bankës së Shqipërisë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS) dhe modeleve të bankave qendrore moderne; u auditua për herë të parë Banka e Shqipërisë (viti 1999) nga auditorë të pavarur; u hartua nga punonjësit e Bankës së Shqipërisë manuali kontabël i vetë Bankës. Në fushën e pagesave u organizua sistemi ndërbankar i kleringut të çeqeve e urdhërpagesave dhe baza rregullative e tij; u fut në përdorim SËIFT-i për pagesat e brendshme, i cili eliminoi shkëmbimin fizik të urdhërpagesave si dhe filluan të përdreshin instrumentet e reja të pagesës si 'urdhër për debitim direkt' dhe 'urdhër për pagesë periodike' dhe standardizimi i tyre.

Gjatë viteve 2001-2002 u zbatua projekti i "Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Thesarit", i cili përbën një zgjidhje të plotë e moderne të sistemit të informacionit për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë.

Objektivi strategjik i Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit kontabël është realizimi i një sistemi kontabël modern dhe të sigurtë që të jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS). Për realizimin e këtij objektivi strategjik vëmendja do të përqendrohet në:

Realizimin e plotë të projektit ATM. Realizimi i këtij sistemi do të sigurojë krijimin e një sistemi të integruar kontabël në Bankën e Shqipërisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (IAS) si dhe me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit (GAAP).

Përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit. Nisur nga objektivi përgjithshëm sipas të cilit, bankat qendrore të vendeve europiane do të fillojnë zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit duke filluar nga 1 janari i vitit 2004, Banka e Shqipërisë synon t'i paraprijë realizimit të këtij objektivi.

Administrimi i planbuxhetit të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas qendrave të kostos. Implementimi i sistemit të ri kontabël krijon mundësinë për një planifikim dhe administrim efektiv të shpenzimeve dhe të ardhurave nga aktiviteti i Bankës së Shqipërisë. Administrimi dhe ndjekja e zbatimit të planbuxhetit sipas qendrave të kostos është një nga synimet e afërta të Zyrës së Buxhetit pranë Departamentit të Kontabilitetit e Pagesave.

Objektivi strategjik i Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit të pagesave është realizimi i një sistemi pagesash modern, eficient e të sigurtë që:

- Të jetë në përputhje të plotë me 10 parimet bazë të përcaktuara nga CPSS për Sistemet e Pagesave Sistemisht të Rëndësishme;
- Të sigurojë një platformë dhe aftësi operacionale të përshtatshme për një këmbim të sigurtë dhe eficient vlerash;
- T'i krijojë përdoruesit vendas dhe të huaj një besim më të madh në aftësitë dhe në sigurinë e sistemit bankar shqiptar;

Në drejtimin e rolit operacional të sistemit të pagesave, planet e Departamentit të Kontabilitetit e Pagesave synojnë përfundimin e dy projekteve të mëdha që do të modernizojnë sistemet ndërbankare të pagesave e shlyerjes:

Projekti RTGS (*Real-Time Gross Settlement*) është sistemi i shlyerjeve të pagesave bruto në kohë reale. Në kontrast me sistemet me bazë neto, siç është sistemi aktual i kleringut, RTGS përpunon pagesat ndërbankare në mënyrë individuale dhe të vazhdueshme gjatë ditës. Shlyerja finale e tyre në llogaritë e bankave pranë bankës qendrore, bëhet në kohë reale dhe është e përvokueshme.

Projekti ACH (*Automated Clearing House*) është sistemi i automatizuar për kleringun dhe për shlyerjen e pagesave ndërbankare me vlerë të vogël të iniciuara nga klientët. Ky projekt do të jetë vazhdim logjik dhe do të pasojë implementimin e sistemit RTGS.

Në drejtim të rolit të mbikëqyrësit dhe rregullatorit të sistemit të pagesave do të synohet përmirësimi e plotësimi i bazës rregullative dhe përafrimi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare, kryesisht me legjislacionin e Bashkimit Europian.